



Temat e Takimit:	1. Prezantimi i projektit për ndërtimin e Kishës Shën Nënë Tereza 2. Informacione mbi hapat e marrë deri tani për restaurimin e urës së Dugajevës 3. Çështje të tjera
Data:	16.06.2024
Ora:	11:00 – 15:00 Uhr
Vendndodhja:	St. Gallerstrasse 73, 9230, Flawil, Schweiz (Zvicer)
Pjesëmarrësit:	Nikollë Ukgjini, Zef Shala, Betim Gojani, Gazmend Berisha, Mark Berisha, Augustin Berisha, Gjon Ukgjini, Lazer Ukgjini, Zog Berisha, Tomë Gojani, Marjan Gojani, Petrit Gojani, David Gjini, Kolë Berisha
Kryesuesi:	Kolë Berisha
Dokumentator:	Tomë Gojani dhe Marjan Gojani Përmbledhja, plotësimi dhe përpunimi redaktues i procesverbalit: Kolë Berisha

Prezantimi i projektit për ndërtimin e Kishës Shën Nënë Tereza në Dugajevë, iniciuar nga Kolë Berisha

Mbledhja u hap nga Z. Kolë Berisha, i cili falënderoi pjesëmarrësit dhe pronarin e lokalit, Z. Lazer Ukgjini, për mundësinë e mbajtjes së mbledhjes në këtë lokal dhe pastaj theksoi se ne duhet të ndihemi krenarë për privilegjin që na është dhënë për të pasur kishën e parë në botë të dedikuar Shën Nënë Terezës në fshatin tonë, ndërsa Z. Nikollë Ukgjini shtoi se jemi jo vetëm të privilegjuar, por edhe shumë të nderuar për këtë mundësi.

Z. Kolë Berisha, si iniciator i këtij projekti, prezantoi qëllimet e projektit dhe ofertën e detajuar të firmës Fokus Group për ndërtimin e kishës, duke përfshirë kostot e propozuara.

Projekti për ndërtimin e strukturës kryesore është vlerësuar të kushtojë 162,000 Euro, ndërsa për përfundimin e plotë kostoja arrin në 274,000 Euro, e reduktuar pas intervenimit të Gjok Marjan Martinut nga SHBA me pronarin e firmës Focus Group, nga 274,000 në 239,000 Euro.

Gjithashtu, u shpjegua plani i financimit, i cili ishte miratuar në dy mbledhjet e mbajtura në Nor të Klinës në fillim të marsit 2024.

Në dy mbledhjet e mbajtura në Nor të Klinës, në fillim të marsit 2024, pjesëmarrësit Don Ambroz Demaj, Ded Gojani, Nikollë Nikprelaj, Fran Berisha, Nikollë Gojani dhe Kolë Berisha ranë dakord për hapjen e një llogarie të veçantë për grumbullimin e fondeve për ndërtimin e Kishës së Shën Terezës në Dugajevë, duke përdorur llogarinë e Ipeshkvisë së Kosovës, me qëllim për të lehtësuar procedurat teknike dhe për të përfituar nga avantazhet që ofron kjo qasje.



U vendos gjithashtu që përdorimi i fondeve të bëhet vetëm me nënshkrimin e përbashkët të personave të autorizuar, të përcaktuar në marrëveshjen e arritur në dy mbledhjet e mbajtura në Nor të Klinës. Asnjë nga personat e autorizuar, përfshirë Don Ambroz Demajn, nuk mund të disponojë ose të përdorë fondet në mënyrë të pavarur. Çdo përdorim i fondeve duhet të bëhet në përputhje me vendimet e grupit përgjegjës dhe vetëm me nënshkrimin e përbashkët të personave të autorizuar.

Në vazhdim të diskutimeve, Z. Lazer Ukgjini theksoi se ky projekt, i cili na bashkon sot në emër të Shën Nënë Terezës, është dhe do të mbetet një trashëgimi kulturore. Ai sugjeroi që për grumbullimin e fondeve do të ishte më efektive hapja e llogarive në Zvicër, Gjermani, Amerikë dhe Austri, vende ku jetojnë shumica e kontribuuesve. Këtë ide e mbështeti edhe Z. Zog Berisha, i cili shtoi se nuk duhet të harrojmë mundësinë e mbështetjes nga institucionet ndërkombëtare. Prandaj, vendimi për një llogari nëpërmjet lpushkvisë së Kosovës duhet të mbetet i hapur, duke shqyrtuar edhe mundësi të tjera që do të ishin më të përshtatshme dhe më të besueshme për donatorët ndërkombëtarë.

Më pas, fjalën e mori Z. Petrit Gojani dhe shprehu mendimin se kostot për ndërtimin e një kishe të re janë shumë të larta dhe mund të jenë të papërballueshme për mundësitë e fshatit Dugajevë. Propozimi i tij ishte që kisha ekzistuese të renovohej, duke sjellë një kosto më të ulët. Tom Gojani, Gazmend Berisha, Marjan Gojani, Gjon Ukgjini, Betim Gojani me fjal dhe shumë të tjerë me pohime shprehen mbështetjen e tyre për këtë ide. Pastaj, kryesuesi i mbledhjes, Z. Kolë Berisha, prezantoi planin e propozuar nga Z. Gustin Berisha, sipas të cilit çdo familje e gjeneratës së tyre do t'i dhurojë 1000 Euro, kurse gjeneratat e tjera janë të mirëpritura në qoftë se kontribuojnë në mënyrë vullnetare sipas mundësive të tyre. Në këtë moment u lajmërua Z. Mark Berisha dhe ai premtoi 2000 Euro.

Z. Zef Shala përmendi se edhe Kristian Uka Gjini ka dhuruar 2000 Franga për ndërtimin e kësaj kishe, dhe nga të pranishmit u tha se ka edhe premtime të tjera me shuma prej 10000 Euro (Lek Gojani, Anton Gojani, Zef Shala dhe Gjok Martini).

Në fund u morën këto konkluzione dhe vendime: Augustin Berisha dhe Nikollë Ukgjini do të udhëtojnë në Kosovë dhe do të angazhohen për të marrë oferta nga disa firma të ndryshme për renovimin e kishës ekzistuese. Pas marrjes së rezultateve, Kolë Berisha do të organizojë një mbledhje online me të gjithë banorët e Dugajevës që dëshirojnë të marrin pjesë, duke prezantuar të gjitha opsionet e diskutuara deri tani në lidhje me modalitetet e ndërtimit dhe financimit. Nëse kemi donacione nga subjektet ndërkombëtare për ndërtimin e kishës së re në ndërkohë, atëherë mbetet vetëm ky opsion në fuqi.



Informacione mbi hapat e marrë deri tani për restaurimin e urës së Dugajevës

Kryesuesi i mbledhjes, Z. Kolë Berisha, informoi pjesëmarrësit për hapat që janë marrë për këtë çështje dhe informoi se ai ju ka drejtuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dy herë, një herë përmes E-Mail-it dhe një herë me letër, por deri më tani nuk kemi marrë përgjigje. Ai shprehu besimin se me ndihmën e Zotit, ky projekt do të përfundojë me sukses.

Çështje të tjera

Më në fund, të gjithë të pranishmit, të cilët patën mundësinë e faktorit kohor, shkuan të organizuar në restorantin ku Z. Hil Gjoka, një dugojevas që jeton për shumë vite në Zvicër, po e festonte me të afërmit dhe miqtë e tij festën e pensionimit, në një atmosferë të bujshme dhe të hareshme, si dhe të shoqëruar me valle tradicionale shqiptare me tupana, e perfunduam këtë ditë të bukur.